



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 10 korrik 2012

MENDIMI MOSPAJTUES I GJYQTARËVE
Ivan Ćukalović dhe Altay Suroy

në

Kërkesën nr. KI37/10

Parashtruesit

Stanojević Nebojša, Marinković Dragan
dhe 118 ish të punësuarit e „N.SH. Banja e Kllokotit“

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës
Supreme Nr. SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006
dhe Aktvendimit Nr. SCEL 06-016 të datës 31 janar 2007

1. Me respekt të thellë për kolegët tanë, e ndjejmë si të nevojshme për të arsyetuar mospajtimin tonë në lidhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për papranueshmërinë e kërkesës në rastin e KI37/10, me të cilin hedhet poshtë kërkesa e Stanojević Nebojša, Marinković Dragan dhe 118 ish të punësuarve në „D.P. Banja e Kllokotit“ për kompensimin me rastin e privatizimit të ndërmarrjes në fjalë.
2. Kërkesa e parashtruesve është hedhur poshtë me arsyetimin e cekur në paragrafin 29, se parashtruesit kanë parashtruar rastin në Gjykatën Kushtetuese më 2 qershor 2010, përderisa vendimi i fundit në lidhje me këtë rast është sjellë nga ana e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nr. SCEL 06-016- më 31 janari 2007. Më tutje thuhet se kërkesa ka të bëjë me ngjarjet e para 15 qershorit 2008, përkatësisht para hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, dhe me këtë kërkesa është *ratione temporis* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit.
3. Sipas bindjes sonë, këto pretendime nuk kanë as mbështetje juridike as faktike për arsyet në vijim: Duhet përmendur se ndërmarrja „N.SH. Banja e Kllokotit“ përbëhet nga dy njësi punuese:
 - a) njësia punuese Fabrika e ujit mineral në Kllokot, dhe
 - b) njësia punuese Stacionari (Qendra për Shërim dhe Rehabilitim) gjithashtu në Kllokot.
4. Parashtruesit e kërkesës kanë punuar në pjesën e Njesisë Punuese Stacionari (Qendra për Shërim dhe Rehabilitim)

5. Me rastin e privatizimit të njësisë së parë të ndërmarrjes më 24 nëntor 2005, AKM ka përcaktuar listën e punëtorëve të cilët plotësojnë kushtet për 20 % të pjesës së mjeteve. Lista e punëtorëve është publikuar në gazetën e përditshme në gjuhën shqipe Zëri dhe Koha ditore më 28 dhe 29 qershor dhe më 1 korrik 2006 në gazetën e përditshme Danas dhe Blic, të cilat publikohen në Republikën e Serbisë.
6. Punëtorët e njësisë punuese Stacionari (Qendra për shërim dhe rehabilitim) të cilët kanë jetuar në Serbi, kanë parë shpalljen dhe kanë parashtruar kërkesat për të hyrë në listë, përderisa ata që kanë mbetur në Kllokot nuk e kanë bërë këtë pasi që në asnjë mënyrë nuk kanë mundur të informohen në lidhje me këtë, pasi ato gazeta nuk shpërndahen në territorin e Republikës së Kosovës dhe e vetmja media në gjuhën serbe „Radio Kllokoti“ nuk ka publikuar shpalljen, gjë që është dokumentuar nga parashtruesit e kërkesës
7. Posaçërisht duhet theksuar se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka këshilluar „**de jure condendo**“ që të bëhet një qarkullim më efektiv dhe me përhapje më të gjerë të listës së punëtorëve që i plotësojnë kushtet në mesin e palëve që mund të jenë potencialisht të dëmtuara.“ ashtu siç përcakton paragrafi i 17 i vendimit të Gjykatës Kushtetuese.
8. Kur ka ardhur deri te përcaktimi i kontratës për privatizimin e Njësisë punuese Stacionari (Qendra për Shërim dhe Rehabilitim) më 15 prill 2010, parashtruesit kanë parashtruar kërkesë për të hyrë në listë të ndarjes së aksioneve, por kërkesa e tyre është hedhur poshtë më 29 tetor 2010, me arsyetimin se lista e punëtorëve është përcaktuar me rastin e privatizimit të pjesës së parë të ndërmarrjes, duke theksuar udhëzimin e zyrës së PSSP ku pohohet se „...nëse ndërmarrja ka më shumë njësi organizative, atëherë krijohet lista e përbashkët për të gjitha njësitë organizative, ndërsa datë zyrtare e privatizimit konsiderohet data e privatizimit të njësisë së parë të së njëjtës ndërmarrje“, prandaj lista e punëtorëve është përcaktuar më 10 tetor 2006 dhe nuk mund të ndërrohet.
9. Të pakënaqur me vendimin e AKM punëtorët parashtruan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese më 2 qershor 2010, pasi tashmë ishin të informuar se kërkesa e tyre e 15 prillit do të hidhet poshtë, siç u vërtetua edhe me vendimin e AKM më 29 tetor 2010.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

10. Në bazë të argumenteve të paraqitura mund të konstatohet qartazi se në këtë rast nuk ka arsye për refuzimin e kërkesës;
11. Siç theksohet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, vendimi i fundit në këtë rast nuk është vendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nr. SCEL 06-016 të 13 janarit, por vendimi i AKM i datës 29 tetor 2010 me të cilin hidhet poshtë kërkesa e punëtorëve për të hyrë në listën e ndarjes së aksioneve më 15 prill 2010.
12. Gjithashtu nuk qëndrojnë as pretendimet se rasti është i papranueshëm si *ratione temporis*, sepse refuzimi që punëtorët të hyjnë në listë është sjellë më 15 prill 2010, kurse vendimi i AKM për ankesën punëtorëve është marrë më 29 tetor 2010, përderisa Kushtetuta ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008.
13. Në anën tjetër duhet përmendur se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat për përdorimin e gjuhës në bazë të nenit 5 paragrafi 1 të Kushtetutës së Kosovës:

„1. Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe“;

14. Sikurse neni 58 paragrafi 2:


“Republika e Kosovës do të promovojë frymën e tolerancës, dialogut dhe do të mbështesë pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe do të respektojë standardet e përcaktuara me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave“.

15. Në këtë rast konkursi për vënien në listë të ndarjes së aksioneve është publikuar vetëm në gjuhën shqipe, derisa në gjuhën serbe është publikuar në gazetën Danas dhe Blic që botohen në Serbi dhe nuk shpërndahej në Kosovë ku edhe jetojnë parashtruesit e kërkesës.
16. Në këtë mënyrë është shkelur e drejta Kushtetuese për përdorimin e gjuhës, e garantuar me nenin 5 paragrafi 1, nenin 58 paragrafi 2 i Kushtetutës së Kosovës.
17. Përfundimisht, edhe vetë Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka konfirmuar se „ duhet të bëhet një qarkullim më efektiv dhe me përhapje më të gjerë të listës së punëtorëve që i plotësojnë kushtet në mesin që palëve mund të jenë potencialisht të dëmtuara“ ashtu siç qëndron në paragrafin 17 të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.
18. Gjithashtu nuk mund të pranohen as argumentet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të paraqitur në paragrafin 21 me të cilin citohet Udhëzimi i PSSP-së që parasheh se „...nëse ndërmarrja ka më shumë njësi organizative, atëherë krijohet lista e përbashkët për të gjitha njësitë organizative, ndërsa datë zyrtare e privatizimit konsiderohet data e privatizimit të njësisë së parë të së njëjtës ndërmarrje“, prandaj lista e punëtorëve është përcaktuar më 10 tetor 2006 dhe nuk mund të ndërrohet.
19. Kjo domethënë se nga momenti i sjelljes së vendimit për privatizim nuk mund të bëhet tjetërsimi i pronës, ndërrimi i statusit ose diçka e ngjashme, dhe përfundimisht kemi raste ku ndërmarrja përbëhet nga më shumë pjesë dhe me privatizim mbulohet vetëm një pjesë e ndërmarrjes.
20. Në bazë të argumenteve të paraqitura, në mënyrë të arsyeshme konsiderojmë se kërkesa e punëtorëve të njësisë punuese Stacionari (Qendra për Shërim dhe Rehabilitim) është i pranueshëm për arsyet në vijim:
- a. Kërkesa është parashtruar në Gjykatën Kushtetuese më 2 qershor 2010 kurse kërkesa e tyre për tu përfshirë në listë është parashtruar më 15 prill 2010, kurse vendimi i AKM për refuzimin e kërkesës së tyre është sjellë më 29 tetor 2010 me të cilën dëshmohen si të pasakta pohimet se rasti është *ratione temporis* i papranueshëm,
- b. Duke mos u publikuar shpallja për përfshirjen e punëtorëve që plotësojnë kushtet në listë në gjuhën serbe në vitin 2006, por vetëm në gjuhën shqipe, parashtruesve të kërkesës pas kësaj **në mënyrë të vazhdueshme u janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë** nga neni 5 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës për përdorimin e gjuhës zyrtare dhe nga neni 32 i Kushtetutës e drejta për shfrytëzimin e mjeteve juridike.
21. Këto pretendime i mbështetë edhe praktika e KEDNJ. Koncepti i vazhdimësisë së situatës ka të bëjë me situatën e shkaktuar si rezultat i veprimeve të vazhdueshme të ndërmarrja nga shteti dhe për pasojë parashtruesit e kërkesës bien viktimë.
22. Në këto raste afatet fillojnë të ecin prej fundit të asaj gjendje të vazhdueshme (*Ülke v. Turkey** (odl.)) KEDNJ.

23. Për sa kohë që ekziston një situatë e tillë nuk zbatohen afatet e parapara me Ligj (*Iordache v. Romania*) KEDNJ. Shih po ashtu edhe (*Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*) *ESLJP*.
24. Nga kjo del se, parashtruesve të kërkesës për shkak të shkeljes së vazhdueshme të së drejtës për përdorimin e gjuhës, u është pamundësuar që jo vetëm të jenë të informuar ashtu që të mund të lajmërohen në konkurs për t'u përfshirë në listë por nuk kanë mundur as të informohen për të drejtën e shfrytëzimit të mjetit juridik, me të cilën u është shkelur e drejta e garantuar me nenin 32 të Kushtetutës.
25. Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, konsiderojmë se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat e garantuara që parashikohen me nenin 5 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe me nenin 58 paragrafi 2, që rezulton më tutje në shkeljen e neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për shkak të shkeljes së vazhdueshme të të drejtave të cekura, prandaj sipas mendimit tonë kërkesa është e pranueshme.

Gjyqtarët,

Ivan Čukalović



Altay Suroy